

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Shkurt, 2015*

Anëtarësia e SBASHK-ut pranoi ofertën e MASHT-it

Përkohësisht pezullohen veprimet sindikale të SBASHK-ut



Për një javë me radhë pas takimit me Ministrin z.Arsim Bajrami, nëpër shkollat e Kosovës ishte biseduar për ofertën e MASHT-it lidhur me realizimin e kërkesave nga

Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar.
Për të përcjellë mendimin e mësimdhënësve lidhur me këtë ofertë më 20 shkurt...(faqe 5)

U realizua një kërkesë e kahershme e SBASHK-ut

Kontratat unike të punës për çdo mësimdhënës



Insistimi i SBASHK-ut në takime me DKA-të dhe qëndrimi kategorik që të mos nënshkruheshin kontratat e larmishme ... (faqe 5)

Vazhdojnë të shtohen radhët e SBASHK-ut Në shkurt edhe 1125 anëtarë të rinj



Fryma e re e punës dhe angazhimi i shtuar i veprimtarëve sindikalë në komuna e në qendër ka bërë që numri i anëtarëve të rinj ... (faqe 6)

Disa nga aktivitetet e projektit SBASHK-KEC për vitin 2015

Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore

Pas përfundimit të vitit të parë (faqe 6)

Bizneset të gatshme për zbritje çmimesh për anëtarët e SBASHK-ut

Numri i marrëveshjeve arrin në 94 sosh

Falë punës së vazhdueshme të kryetarëve komunal sindikal... (faqe 7)

Intervistë me Kryetarin e Sindikatës Komunale të SAF dhe SAM – Suharekë

Gjithmonë jam ndierë mirë si veprimtar i SBASHK-ut

Sadiku me punë e angazhime bëri që të respektohet ... (faqe 3)

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë

Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës**KEC**

Editorial

T'u gëzohemi festave

Ditët, javët e muajt po ikin shpejtë. Të gjithë ne po plakemi e në kujtesën tonë skaliten kohët e shkuara dhe ngjarjet e mëdha. Nuk i harrojmë as gëzimet e pakta e as sfidat e hidhërimet. Një datë e veçantë për mësuesin është dita e tij 7 Marsi. Kësaj feste të madhe duhet t'i gëzohemi e ta festojmë duke lartësuar kujtimin për të gjithë ata që me dashuri ndaj gjuhës e kulturës sonë mbajtën gjallë dëshirën për arsimim nëpër gjenerata. Edhe një 7 Mars e kemi afër dhe SBASHK-u do të vazhdojë me traditën e mirë që për kolegët tanë pensionistë të ndajë nga një mirënjohje dhe nga një orë dore.

Ata me sy të këqij do të thonë eh, nami i madh një mirënjohje dhe një orë, por ata që mendojnë qartë e pa paragjykime do të pranojnë se është ky një gjest i mirë. Mirënjohja do të jetë kujtesë dhe respekt për dekadat e çdo mësuesi në misionin e tij human nëpër dekada e nëpër furtuna në shërbim të arsimit të brezave. Ora është dhuratë modeste mbase, por me akronimin SBASHK do të jetë një kujtesë që lidhet me kohën.



Mësuesit dhe mësueset pensionistë duke shikuar orën dhuratë dhe kohën që ik shpejtë do të kujtojnë rininë dhe ditën e parë me ditar në dorë. Do të kujtojnë SBASHK-un në 25 ditëlindjet që ka. Do të kujtojnë momente gëzimi e kohën e sfidave e pikëpyetjeve të mëdha nëpër vite e dekada. Kjo orë e kjo mirënjohje ka vlerë kujtese e respekti për punën e madhe të mësimdhënësit në edukimin e brezave. Është dhuratë modeste, por me kuptim të plotë në ditën e madhe të festës së shkollës dhe mësuesit.

Respekt i lartë për Ju kolegë e kolege që po pensionoheni dhe gëzuar sot e gjithmonë festën e madhe. Gëzuar 7 Marsi. Festave duhet t'u gëzohemi për hir të kaluarve dhe njerëzve të saj dhe për hir të kohës sonë dhe ardhmërisë. Gëzuar.

Rrahman Jasharaj

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Në kuadër të projektit të përbashkët SBASHK-KEC "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore", SBASHK-u nga 1 marsi 2015 do të ofroj shërbime juridike për anëtarët e vet.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, shpejt do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 19.000 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Implemented by:



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit e Kosovës

KEC



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë

Intervistë me Kryetarin e SAF dhe SAM – Suharekë,
z. Sadik Shala

Gjithmonë jam ndierë mirë si veprimtar i SBASHK-ut



Sadiku me punë e angazhime bëri që të respektohet kudo në Suharekë, por edhe në tërë Kosovën e madje edhe në Shqipëri. Angazhimet i ka të përkushtuara dhe thotë se ndihet mirë kur shihet arritje dhe rezultate në SBASHK. Ai u bë i respektuar edhe në fushën e shkrimeve.

Aktivitetin e tij e vlerësuan lartë edhe në Frashër e Përmet të Shqipërisë. Ata e nderuan me titullin, “Nderi i Komunës së Frashrit”.

Arsimimi Sot:

1. Kush është Sadik Shala?

Shala:

Jam mësues në Shkollën e Mesme të Ulët “Flamuri i Arbrit” në Reshtan të Komunës së Suharekës. I diplomuar me përgatitje të Shkollës Normale. Kam përcjellë trajnime të rëndësishme për mësimdhënies cilësore sipas kurrikulës arsimore. I përkushtuar për edukimin e brezave të rinj. Nga puna 35 vjeçare e të cilit sot kanë dalë me qindra kuadro të profileve të ndryshme të angazhuara si në nivelin lokal ashtu edhe atë republikan. Edukator i dalluar e i shpërblyer disa herë nga instancat komunale. Aktiv në jetën shoqërore, politike e sociale në vendin ku jetoj dhe veproj.

Arsimimi Sot:

2. Aktiviteti juaj sindikal?

Shala:

Aktualisht jam kryetar i Kuvendit të SAF e SAM në Suharekë. Që nga pavarësimi i arsimit shqip në vitet 90-ta nga atëherë kur pushtuesi serbo-sllave donte të shfaroste çdo gjë që frymonte shqip, kam qenë nënkryetar për regjionin e Prizrenit në LASH (Lidhja e Arsimitarëve Shqiptar). Kjo periudhë kohore deri në vitin 2000 ishte një rrugë e përgjakur për shkollën shqipe. LASH-i ishte organ legjitim i organizimit të mësimi të shkollës shqipe në Kosovë gjatë periudhës së viteve 1990 deri 1999.

Anëtarë i përkushtuar i Sindikatës së Arsimit në Kosovë që nga fillimet e aktivitetit sindikal të SBASHK-ut. Që nga viti 2007 kryetar i Kuvendit të SAF e SAM në Suharekë. Kam treguar aktivitet të theksuar në nivel komunal e po ashtu edhe qendror. Pjesëmarrës në grevën e urisë të punëtorëve të arsimit të vitit 2007, grevë e cila dha rezultat ndryshimin pozitiv të politikave sindikale ndaj organeve vendim marrëse qeveritare

mbi arsimin. Kontribut të rëndësishëm kam dhënë në inicimin e ligjit për punëtorët arsimor që punuan në periudhën kohore prej vitit 1990 deri 1999. Ky Ligj do t'i njehe punëtorët arsimor të asaj kohe si “Njerëz të Merituar të Kosovës”.

Kam udhëhequr trajnime dhe seminare të ndryshme të SBASHK-ut për arsimtarët në komunën tonë. Trajnim i rëndësishëm për arsimtarët ishte edhe përgatitje e mësimdhënësve për shfrytëzim të pajisjeve kompjuterike ECDL, ku u trajnuan dhe aftësuan mësimdhënës dhe në komunën tonë.

Tashmë jemi dëshmitarë se zëri i anëtarit sindikal është zë i fuqishëm sepse vetëm si i tillë ai mund t' i shtyjë proceset përpara për një mirëqenie më të mirë të mësuesit tonë e që si rezultat kthyes do të kishim një angazhim më të theksuar e serioz për një arsimim dhe edukim edhe më të mirë e më cilësor të brezave të rinj si e ardhmja e shoqërisë sonë.

Arsimimi Sot:

3. Sa është përfshirja e të rinjve dhe femrave në arsim në komunën tuaj?

Shala:

Organizimi sindikal i arsimit në komunën tonë është relativisht i kënaqshëm, kështu nga gjithsej 30 shkolla kemi njësi sindikale në themeluar në të gjitha shkollat. Megjithatë numri i punëtorëve arsimor nga aspekti i moshës dhe i gjinisë është dukshëm në favor të mësimdhënësve të rinj dhe të gjinisë femërore, ndërkaq në angazhimin sindikal nuk është i kënaqshëm pjesëmarrja e tyre. Kështu ne udhëheqjen e njërive sindikale në shkolla kryesisht janë mësimdhënës me përvojë pune shumëvjeçare ndërkaq nga aspekti gjinor i kemi vetëm 4 kryetare të njërive sindikale në shkolla. Arsytet për mos angazhim më të theksuar të gjinisë femërore mbase mund të jenë angazhimet dhe obligimet familjare të ndryshme nga të mësimdhënësve të gjinisë mashkullore. Natyrisht se kjo do të jetë një synim yni në përmirësimin e kësaj strukture gjinore në udhëheqje, konform edhe pjesëmarrjes në arsim.

Arsimimi Sot:

4. Cilat trajnime do t'ia propozoni SBASHK-ut për anëtarësinë e vet?

Shala:

Duke u mbështetur në rëndësinë e organizimit të trajnimeve në avancimin profesional të mësimdhënësve konform reformave në arsim e të cilat janë të domosdoshme pas periudhave në të cilat ka kaluar arsimi shqip në Kosovë. Ndryshimi i Kurrikulës shkollore kërkon në të njëjtën kohë edhe mësimdhënës të përgatitur me metodat bashkëkohore të mësimdhënies për një mësim-nxënies sa më të mirë. Prandaj në këtë aspekt do të kërkoja që të organizohen më shumë trajnime e seminare në avancimin

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



metodologjik bashkëkohor në punën edukative e arsimore të mësimdhënësve. Kjo mund të realizohet në mënyrë shumë efikase duke bashkëpunuar me KEC-in i cili si institucion trajnues vlerësohet nga mësimdhënësit.

Arsimimi Sot:

5. Merreni edhe me shkrime dhe keni marrë edhe mirënjohje publike, na thoni diçka më shumë?

Shala:

Të shkruash artikuj profesional është një art më vete, është një punë kërkimore e thelluar mendore e shkencore. Relativisht shumë kam shkruar në revista arsimore si “Shkëndija” e tani “Mësuesi”, në revistën sindikale të Kosovës por edhe në disa revista në Shqipëri.

Kam të botuar një Monografi “Suhareka ndër vite” e cila është vlerësuar si një dëshmi e qëndresës së popullit të Kosovës dhe të shkollës shqipe dhe në anën tjetër dëshmi të krimeve dhe masakrës serbe në komunën e Suharekës.

Për angazhime të theksuara në aspektin e bashkëpunimit kulturor e arsimor me shkolla dhe institucione kulturore me Shqipërinë, e posaçërisht me Prefekturën e Gjirokastrës, me Bashkinë e Përmetit e në veçanti me Komunën Frashër. Ky bashkëpunim ka filluar që nga viti 1999 e vazhdon me ritme të rritura edhe sot e kësaj dite. Për hir të kësaj edhe jam vlerësuar disa herë me Mirënjohje ndërkaq në “Ditët e Naimit”, në vitin 2014 jam nderuar me titullin, “Nderi i Komunës së Frashrit”

Arsimimi Sot:

6. Keni mjaft arritje me nënshkrimin e marrëveshjeve për zbritje çmimesh për anëtarësinë. Si po funksionojnë ato?

Shala:

Që nga viti 2014 në nivel qendror SBASHK-u ka filluar një iniciativë me bizneset për ofrimin e lehtësirave ndaj punëtorëve arsimor, anëtarë sindikal. Sipas kësaj nisme unë si kryetar dege kam arritur të sigurojë mbështetje relativisht të gjerë nga pronarët e bizneseve, duke filluar nga ordinancat private mjekësore nga të gjitha profilet, barnatore, laboratorë, rëntgen, ordinanca dentare stomatologjike, shërbime nga servise dhe kontrollime teknike për makina, shërbime për auto shkolla dhe sigurime etj. Megjithëse ky aktivitet ka filluar nga shtatori e kënde, mësimdhënësit janë të kënaqur me këtë projekt që ndihmon mësimdhënësit. Shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë pronarët për një bashkëpunim dhe mirëkuptim ndaj mësimdhënësve për lehtësira në shërbimet e ndryshme të tyre.

Arsimimi Sot:

7. Çfarë do të veçonit për të mirë në SBASHK?

Shala:

Do ta veçoja punën dhe angazhimin maksimal të stafit udhëheqës të SBASHK-ut, duke filluar nga kryetari i

parë Prof. Agim Hyseni, Mr.Ali Shabanaj e tani edhe z.Rahman Jasharaj, pa i anashkaluar edhe shumë aktivist tjerë që janë shumë konstruktivë në organizimet arsimore sindikale, të cilët i kanalizuan mjaft mirë kërkesat e punëtorëve të arsimit duke filluar nga njësitë sindikale në shkolla ndaj institucioneve përgjegjëse qeveritare arsimore. E çmoj shumë sineritetin, transparencën dhe e urrejë mashtrimin, korrupsionin dhe dukuritë tjera negative që janë si sëmundje kanceroze të shoqërisë dhe shtetit tonë.

Dua të theksoj angazhimin e SBASHK-ut në dërgimin e anëtarëve sindikal në pushimet verore në bregdetin shqiptar ndërkaq vetëm këtë vit do të përfitojnë mbase 20 pensionistë nga një dhuratë modeste, orë dore të gravuruar për punëtorë pensionistë, anëtarë të sindikatës SBASHK.

Arsimimi Sot:

8. Këshilla juaj për organet udhëheqëse në një anë dhe për anëtarët e SBASHK-ut në anën tjetër?

Shala:

Megjithëse organizimi sindikal shpesh herë konsiderohet opozitë e Institucioneve qeveritare arsimore unë më tepër do të dëshiroja që kjo të shndërrohet në partneritet të rëndësishëm për përgatitjen e të rinjve me një edukim dhe arsim cilësor dhe në luftimin e dukurive negative në shoqëri. Partneritet në luftimin e dukurive të dhimbshme të analfabetizmit, braktisjes së shkollës nga të rinjtë dhe kur është fjala për shëndetin, të angazhohemi si një tërësi dhe ti ruajmë ata nga përdorimi i substancave narkotike, problem i cili ka filluar të shqetësoi shoqërinë në përgjithësi.

Aktivitetet e kohës së fundit tregojnë se duam dhe mundemi të ndërtojmë strategji të përbashkëta me organet qeveritare udhëheqëse dhe SBASHK-ut nga ana tjetër. Të gjitha këto mund të evitohen me një bashkëpunim të ngushtë të trekëndëshit arsimor ndërmjet mësuesit, shkollës e prindit por me një mbështetje të fuqishme nga komuniteti dhe institucionet tjera qeveritare.

Arsimimi Sot:

9. Për fund?

Shala:

Për fund dua të falënderoj qëndrim dinjitoz të të gjithë punëtorëve sindikalë të arsimit posaçërisht të Komunës e Suharekës, t’u uroj gjithë punëtorëve të arsimit implementim të plotë të Kontratës Kolektive të Arsimit. I uroj revistës elektronike të SBASHK-ut “Arsimimi Sot” që të shpalos sa më mirë dhe t’i lartësojë vlerat e sukseseve të SBASHK-ut që do të ndikojnë në anëtarësime të reja të punëtorëve të arsimit të cilët ende hezitojnë të anëtarësohen në SBASHK, ndërkaq me dëshirë i shfrytëzojnë përfitimet nga rezultatet e arritura me aktivitet sindikal të anëtarëve të saj.

Me respekt,

Sadik Shala
Suharekë

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Anëtarësia e SBASHK-ut pranoi ofertën e MASHT-it

Përkohësisht pezullohen veprimet sindikale të SBASHK-ut



Pas përfundimit të veprimit të tretë sindikal, SBASHK-u asnjëherë nuk u ndalë duke kërkuar takime me qeverinë dhe MASHT-in, për arsye të gjetjes së mundësisë për implementimin e katër pikave të Kontratës Kolektive. Kështu me 13 shkurt një delegacion i SBASHK-ut, kryesuar nga kryetari z.Jasharaj u takuan me Ministrin e MASHT-it z.Bajrami, ku u zhvillua një diskutim i gjatë në përpjekje për të gjetur mundësi për realizimin e kërkesave të SBASHK-ut. Në këtë takim Ministri Bajrami i ka prezantuar përfaqësuesve të SBASHK-ut ofertën e MASHT-it duke theksuar se përvoja e punës në vlerë prej 0.5 % për çdo vit pune do të nis të zbatohet në mënyrë retroaktive që me pagën e shkurtit apo eventualisht të marsit, kompensimin prej 70 % për biletat e udhëtimit do të realizohet nga niveli komunal, tri pagat për mësimdhënësit me rastin e pensionimit janë po ashtu obligim ligjor dhe këtë do ta bëjnë komunat, pasi u takon ky obligim. Lidhur me shujtën Ministri Bajrami është shprehur se kjo do të realizohet me rishikimin e buxhetit, që për shkak të pushimit të verës, i bie nga shtatori i këtij viti.

Delegacioni i SBASHK-ut i ka deklaruar Ministrin Bajrami se me këtë ofertë do ta njoftojnë anëtarësinë ku do të mbledhet Këshilli Drejtues, i cili do të vendos në bazë të vullnetit të shprehur nga të punësuarit në Arsimin Parauniversitar.

Për një javë me radhë pas takimit me Ministrin z.Arsim Bajrami, nëpër shkollat e Kosovës ishte biseduar për ofertën e MASHT-it lidhur me realizimin e kërkesave nga Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar.

Për të përcjellë mendimin e mësimdhënësve lidhur me këtë ofertë më 20 shkurt janë takuar kryetarët e niveleve komunale të SBASHK-ut. Ata një nga një kanë raportuar për komunat e tyre.

Nga prezantimi i bërë prej kryetarëve u arrit qëndrimi i përbashkët që greva të pezullohet. SBASHK-u pret që kompensimi prej 0.5% për çdo vit shërbimi të filloj së aplikuari me pagën e muajit mars 2015 në formë retroaktive duke përfshirë edhe muajin Janar dhe Shkurt të këtij viti.

Takimit i është bashkangjitur edhe Ministri i MASHT-it z.Arsim Bajrami, i cili ka lavdëruar mësimdhënësit



dhe pastaj është shprehur i gatshëm të vazhdojë angazhimet me SBASHK-un në shërbim të arsimit të Kosovës.

Ai është shprehur se do të angazhohet vazhdimisht për implementimin e Kontratës Kolektive duke e marrë si shembull të mirë kontratën individuale në kohë të pacaktuar.

Ministri Bajrami ka thënë se prioritet i Qeverisë dhe MASHT-it mbetet arsimit në Kosovë.

Pas kësaj Ministri Bajrami dhe kryetari i SBASHK-ut Jasharaj kanë dalë para medieve duke prezantuar qëndrimet e institucioneve që përfaqësojnë.

Të gjithë të pranishmit duke përfshirë kryesinë dhe kryetarët e sindikatave komunale ishin të një mendimi se në qoftë se cilado nga pikat e ofertës së MASHT-it nuk realizohet me kohë, në afatet e parapara, SBASHK-u menjëherë do ta rikthen veprimin sindikal (grevën).

U realizua një kërkesë e kahershme e SBASHK-ut

Kontratat unike të punës për çdo mësimdhënë



Insistimi i SBASHK-ut në takime me DKA-të dhe qëndrimi kategorik që të mos nënshkruheshin kontratat e larmishme individuale të punës, kanë sjellë rezultat ngase këtë muaj në ambientet e MASHT-it e në prezencë të delegacionit të SBASHK-ut, ministri Bajrami ka promovuar kontratën unike të punës që vlen për tërë Kosovën.

Me këtë rast është bërë nënshkrimi simbolik i katër kontratave të para të punës në mes të drejtorëve të DKA-vë të komunave Gjakovë, Prizren, Prishtinë dhe Kamenicë dhe katër mësimdhënësve nga këto komuna.

SBASHK-u e konsideron si arritje këtë moment dhe si realizim të një pjese të kontratës kolektive.

Urojmë që edhe pjesët tjera të Kontratës Kolektive të realizohen sikur kjo e për çka SBASHK-u vazhdon me angazhimet.

Vlen të theksohet se me këtë Kontratë individuale të punës do të pajisen të gjithë mësimdhënësit që kanë kualifikim dhe vend adekuat pune.

Implemented by:

Vazhdojnë të shtohen radhët e SBASHK-ut Në shkurt edhe 1125 anëtarë të rinj

Fryma e re e punës dhe angazhimi i shtuar i veprimtarëve sindikalë në komuna e në qendër ka bërë që numri i anëtarëve të rinj në SBASHK sa vjen e shtohet. Ata kanë parë nga afër se SBASHK-u po angazhohet sinqerisht në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe në realizimin e kërkesave brenda mundësive dhe realitetit në të cilin po frymojmë.

Në Kryesinë e SBASHK-ut me kënaqësi kanë konstatuar duke u bazuar në listat e ardhura për anëtarësim nga 5 janari deri më 5 shkurt, SBASHK-ut i janë bashkuar edhe 1125 anëtarë të rinj nga

Arsimi Parauniversitar, gjegjësisht nga shkollat fillore e të mesme të Kosovës.

Kjo situatë e re na bën të ndjehemi krenar, por edhe na obligon për punë e angazhime të shtuara.

SBASHK-u do të vazhdojë me angazhimet për të lidhur edhe shumë marrëveshje në shërbim të mësimdhënësve sindikalistë. Kujtojmë se deri sot në të gjitha komunat e Kosovës janë nënshkruar 94 marrëveshje me bizneset dhe me institucionet private shëndetësore për zbritje çmimesh për mësimdhënës të anëtarë të SBASHK-ut.



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës
KEC

Disa nga aktivitetet e projektit SBASHK-KEC për vitin 2015

Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore

Pas përfundimit të vitit të parë të këtij projekti (2014), SBASHK-u dhe KEC-i vazhdojnë implementimin e pjesës së dytë (2015).

Efektet e këtij projekti janë të kapshme dhe evidente qysh nga viti i parë.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme janë:

- Anëtarësia dhe shërbimet
- Mirëmbajtja dhe zhvillimi i mëtejme i ueb-faqes
- Komunikimi online – *Pyetje Përgjigje* me anëtarësinë
- Negocimi i SBASHK-ut me donatorë të jashtëm dhe të brendshëm për ulje çmimesh për shërbime të ndryshme siç janë ato arsimore, hoteliere, shëndetësore, sigurime dhe mallra të ndryshme. Deri më tani kemi rreth 90 shërbime të tilla dhe ky aktivitet vazhdon.
- Shërbimet juridike për mësimdhënës – këshilla të ndryshme ligjore dhe mbrojtje e të drejtave të punëtorëve para punëdhënësve dhe gjykatave
- Ofrimi i këshillave për zhvillim profesional për mësimdhënës

- Botimi i materialeve promovuese të SBASHK-ut
- Organizimi i fushatës promovuese për produkte të dhëna dhe shtimi i numrit të anëtarësisë
- Organizimi i konferencës së dytë tematike
- Do të formohet një grup punues për monitorimin e licencimit të mësimdhënësve

Dialogu social do të zhvillohet në Këshillin Konsultativ tre palësh (SBASHK-MASHT-AKK). Ky Këshill do të punojë gjatë tërë vitit në seanca të caktuara. Aty do të shtjellohen tema të ndryshme që janë në interes të arsimit dhe mësimdhënësve parauniversitar. Partnerët SBASHK dhe KEC do të jenë në nivel të kryerjes së obligimeve të përcaktuara me projekt. Duhet falënderuar KEC-in për punën dhe bashkëpunimin që ka bërë dhe po bënë për implementimin e këtij projekti. Veçanërisht falënderojmë z.prof. Dukagjin Pupovci dhe znj.Melinda Mula për përkrahjen dhe ndihmën në çdo kohë për arritje të sukseseve dhe efekteve të pritura nga ky projekt.

SBASHK- Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës
KEC – Qendra për Arsim e Kosovës

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

AKK – Asociacioni i Komunave të Kosovës

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Bizneset të gatshme për zbritje çmimesh për anëtarët e SBASHK-ut

Numri i marrëveshjeve arrin në 94 sosh

Falë bashkëpunimit të mirë të qendrës me nivelet komunale dhe punës së vazhdueshme të kryetarëve komunal sindikal dhe qendrës, marrëveshjet për zbritje çmimesh për anëtarësinë e SBASHK-ut, dita ditës po shtohen. Këtu po paraqesim të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani:

Prishtinë:

1. Kolegji **"Globus"** Prishtinë, studime Bachelor dhe Master me zbritje prej 10%
2. Kolegji **"Universum"** Prishtinë, për studime Bachelor dhe Master zbritje 30 %
3. Ordinanca Stomatologjike **"ARDI -DENT"** Prishtinë 15%
4. Ordinanca Stomatologjike **"MO- DENT "** Prishtinë 20%
5. **"Next Market"** Prishtinë
6. Barnatore **"Bayer Pharm"** rr. Ilir Konushevc nr.48, Prishtinë, 10%
7. V.P.S. **"Dear Dent"**, rr. Anton Arapi, Dardani, 10%
8. Spitali i sëmundjeve kardiovaskulare **IMH**,



Preoc, Prishtinë, 15% si dhe ata që pajisen edhe me MED card (te spitalit) përfitojnë edhe 5% zbritje shtese

9. Laboratori **"Bioteknik"**, Prishtinë, 20%
10. Qendra Estetike Italiane **(QEI)**, Prishtinë 50%

Prizren:

1. Barnatorja **"Barkos"** Prizren 10%
2. Ordinanca Stomatologjike **"Kuki Dent"** Prizren 10%

Pejë:

1. **"Kastrati"** Pejë, Karburanti me 1 cent më lirë, Auto larje me 20%, goma të reja 30%, bowling 20%, Piceri 10%
2. **"Magic"** Vitomiricë, Pejë 10 %

Gjakovë:

1. Ordinanca **"Dafota Dent"** Gjakovë 20%
2. Ndërmarrja **"Nertili"** Gjakovë 5%

Klinë:

1. Ina **"Baci Petrol"** Klinë, derivate 2 centë për litër, produkte tjera në depo 2% dhe restaurant 5%
2. NTP **"Pre-Market"** Klinë 3%
3. Barnatorja **"Ariana"** Klinë 10%
4. Poliklinika **"Biolab-Zafi"** Klinë, Vizita specialistike 20%, laborator 25%, intervenimet e vogla kirurgjike 20%, ultrazëri 20%, EKG 20%
5. NTT **"Semirra"** Klinë, gjëra ushqimore 3%, konfeksione (rroba) 5%, mobilieri 5,10 dhe 15%

6. Kompania **"Benita"** Klinë, për të gjitha llojet e zallit 5%, për beton 3%
7. OSI **"Driloni-Med"** Klinë 50%
8. OPS **"Dental"** Klinë 10%
9. Barnatorja **"Doni Farmaci"** Klinë 10%
10. Salloni i auto-pjesëve **"Doruntina"** Klinë 5%
11. NT **"Bujar Electronics"** Klinë 10%
12. NT **"Hidromont"** Klinë 12%
13. NT **"Ereniti"** Klinë 5%



Suharekë

1. Poliklinika **"MED- DIAGNOSTIKA"** Suharekë 50 %
2. Ordinanca stomatologjike **"OPTIDENT"** Suharekë 20%
3. Qendra Diagnostike **"MEDICA"** Suharekë 20%
4. Ordinanca Stomatologjike **"DOLORDENT"** Suharekë 20 %
5. Poliklinika **"Theramed- HB"** Suharekë 20%
6. Auto-servis **"Krasniqi"** Suharekë 20 %
7. OS për sëmundje të fëmijëve **"Neonatus"** Suharekë 20%
8. Barnatore **"Elitapharm"** Suharekë 10%
9. Auto-shkolla **"Genci"**, Suhareke, 20%
10. Autoshkolla **Vlera**, Suhareke, 20%

Gjilan:

1. Ordinanca **"Aspesa"** Gjilan 20%
2. Ordinanca **"Urologu"** Gjilan 20%
3. Barnatorja **"Aloe Pharm"** Gjilan 15%
4. Laboratori **"Hemoslab"** Gjilan 20%
5. Barnatorja **"Alteo"** Gjilan 13%
6. Ordinanca kardiologjike **"Dr. BESIMI"** Gjilan, 30 %
7. Ord. për Sëmundje të Mushkërive, Dr. Nisret Hajrullahu, Gjilan 20%
8. Ordinanca Traumatologjike **"Dr. Lata"** Gjilan 20%



Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit dhe Kulturës

KEC



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Viti:

1. QMFR–Banja “**Nëna Naile**” Klllokot 23%
2. “**Mediterrani Group**” Viti , 4 % ushqimore, 5 % teknika e bardhë dhe 10 % tekstil

Ferizaj:

1. Poliklinika “**EKSTRADENT**” Ferizaj 15%
2. Ndërmarrja “**Melodia PX**” Ferizaj 10%
3. “**Plus Market**” Ferizaj 2%
4. Poliklinika “**Zeka**” Ferizaj 10%
5. Auto-shkolla “**Ridi**” Ferizaj 20%
6. Ndërmarrja “**Fin Performance**” Ferizaj 15%
7. NT “**Guri**” Ferizaj, 2% ushqimore, 5% veshmbathje
8. ORL “**Shëndeti**”, Ferizaj, zbritje 20% për kontroll specialistike, 10% ndërhyrje kirurgjike, 5% për aparate të dëgjimit.
9. Qendra Diagnostike “**PLEUR**” Ferizaj, 15%
10. N.T.P “**Arb-Rini**” Ferizaj, 10%
11. Kompania **IP-Kos** (Italian Petrol), Ferizaj 2 cent

Vushtrri:

1. OPS “**Auris**” Vushtrri 20%
2. Barnatore “**Timi Pharm**” Vushtrri 8%
3. “**Blerta Pharm**” Vushtrri 8%
4. Laboratori “**Labbiohem**” Vushtrri, 10%
5. Barnatore “**Albani Pharm**” Vushtrri 8%
6. I.SH.P “**Vita dent**” Vushtrri 20%
7. **Shpresa e Nenes**, Vushtrri 20%
8. “**ETC**”, Vushtrri 3%
9. Klinika dentare “**Viciadent**”, Vushtrri 20%
10. O.S “**Comfort**”, Vushtrri 20%

Drenas:

1. Ndërmarrja Tregtare “**Jora Center**” Drenas 3 % artikujt ushqimor dhe 7 % tekstil dhe teknikë e bardhë
2. Ordinanca “**Dardani Dent**” Drenas 15 %
3. Ordinanca “**Orioped**” Drenas 20%
4. Ordinanca spec. E Mr.Sci.dr. **Sami Delijaj**, Drenas 20%



Lipjan:

1. Ordinanca Stomatologjike “**DONA- DENT**” Lipjan 20%

Skenderaj:

1. Sh.p.k. “**QTA**” (ushqimore, tekstil, veshmbathje), Skenderaj 3%

Shtime:

1. Ordinanca dentale private “**Cani dent**”, Shtime 20%
2. Depo-market “**Elira**”, Shtime 4%
3. NTP “**Tina**”, Shtime, 7%
4. Market “**Eli-Ab**”, Shtime 3%
5. Market “**Gryka**”, Shtime 5% (pasi të kalohet shuma 50 €)
6. Barnatore “**Sigma 2**”, Shtime 10%
7. Barnatore “**Vita O2**” Shtime, 8%
8. Ordinanca Stomatologjike “**Vita Dent**” Shtime, Nxerrje e dhëmbit 20%, Mbushje e dhëmbit 10%, Mbushje e dhëmbit me trajtim kanalesh 10%, Proteza mobile 10%, Ura metal-porcelan 15%, Ura zirkoni 8%

Mitrovicë:

1. Sh.p.k “**Emona**”, Mitrovicë, 3%
2. Barnatore “**Gentiana-Lutea**” Mitrovicë, 5%



3. NTP “**Kushtrimi**”, Mitrovicë, 10%, po ashtu kjo ndërmarrje për hir të Ditës së Pavarësisë së Kosovës ka ndarë 1000 kg. miell për punëtorët teknik të shkollave të Mitrovicës, që janë në gjendje më të vështirë sociale dhe që janë anëtarë të SBASHK-ut. Të gjithë punëtorët teknik janë takuar në SH.M.T “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë, më datë 16.02.2015, ku edhe iu është bërë ndarja e miellit.

Shqipëri:

1. Kompleksi Hotelier Turistik “**Bonita**” Durrës 20%
2. Objekti hotelier turistik “**Besani**” & “**Ballkan2**” Durrës 20%
3. Hotel “**Pashtriku**” Shkëmbi i Kavajas, 12 euro për fjetje dhe mëngjes, drekë edarkë
4. Hotel “**Kosova**” Shkëmbi i Kavajës 20%
5. Hotel “**Riviera**” Shkëmbi i Kavajës 20%
6. Hotel “**Nacional**” Shkëmbi i Kavajës 15 %
7. Hotel “**Athina**” Velipojë 15 %



Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit dhe Kulturës

KEC



Sindikatat komunale gjatë këtij muaji

Në këtë numër të gazetës elektronike "Arsimimi Sot", po paraqesim disa nga aktivitetet e tri komunave gjatë muajit shkurt 2015

Prishtinë - z. Ahmet Pllana (Kryetar i SAF & SAM në këtë komunë)

Gjatë muajit shkurt SBASHK-u në komunën e Prishtinës janë zhvilluar disa aktivitete sindikale me kryetarët e shoqatave sindikale nëpër shkolla të Komunës së Prishtinës.

Aktivitetet që janë zhvilluar janë kryesisht rreth implementimit të kontratës kolektive, anëtarësimi i disa shkollave në SBASHK dhe marrëveshje me biznese për zbritje çmimesh për mësimdhënësit anëtarë të SBASHK-ut.

Sa i përket implementimit të kontratës kolektive pas një marrëveshjeje me Ministrin e Arsimit është kërkuar nga anëtarësia që të japin mendimin lidhur me ofertën e MASHT-it, ku në një takim me kryetarët e shoqatave sindikale, ku kanë shprehur qëndrimin e anëtarësisë se e pranojmë ofertën e MASHT-it dhe do t'i jepet kohë qeverisë për shujtën e punëtorëve prej (2 euro) që është premtuar deri në shtator, pasi që të rishqyrtohet buxheti në muajin qershor.

Kryesia e SAF dhe SAM- Prishtinë është duke punuar vazhdimisht për anëtarësimin e anëtarëve të rijë në SBASHK.

Gjatë kësaj periudhe në SBASHK është anëtarësuar këto shkolla të komunës së Prishtinës: sh.f "Nazim

Gafurri", "Meto Bajraktari", "Nexhmi Mustafa" Besi, "Ali Kelmendi" Barilevë dhe shkolla e mesme profesionale "Shtjefën Gjeqovi".

SBASHK-ut i dhanë peshë të madhe edhe aktiviteti për marrëveshjet e arritura me biznese dhe institucione për zbritje çmimesh për mësimdhënësit sindikalist:



Laboratori "Bioteknik", Kolegji "Universum" dhe "Globus" në Prishtinë, disa ordianca stomatologjike dhe disa barnatore.

Kryesia e SAF dhe SAM- Prishtinë do të organizoj edhe një aktivitet tjetër për nder të 7 marsit ditës së mësuesit për mësimdhënësit që kanë dal në pension prej 1 prillit 2014 deri me 31 mars 2015. Aktivitetet tona nuk kanë të ndalur, tani ato po vazhdojnë me organizimin e një turniri të futbollit në mes të shkollave të Komunës së Prishtinës.

Skënderaj - z. Ramiz Polaci (Kryetar i SAF & SAM në këtë komunë)



Roli i femrës në shoqëri-Fuqizimi i saj

Sindikata e AF dhe AM në Skenderaj gjatë muajit shkurt mbajti një punëtori në dy grupe me temën „Roli i femrës në shoqëri-fuqizimi i saj”, ku morën pjesë kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave dhe mësimdhënësit e aktivistë sindikal. Përveç anëtarëve të Kryesisë së SK AF dhe AM të Skënderajt, të cilët ishin organizatorë të kësaj punëtorie, diskutuan edhe pjesëmarrës tjerë që me idetë dhe mendimet e tyre kontribuan në sensibilizimin e rolit të femrës në shoqëri për pjesëmarrjen me aktive të saj në jetën politike, sindikale dhe menaxheriale. U tha se numri i femrave në organet drejtuese nuk është në proporcion me numrin e të punësuarve në të dy

sektorët. Për shembull në Komunën e Skenderajt numri i femrave të punësuar është mbi tridhjetë për qind, kurse në pozita vendimmarrëse dhe menaxheriale nuk arrijnë dhjetë për qind. Kjo më së miri faktohet me gjendjen në arsim, ku nga 27 shkolla, vetëm dy sosh menaxhohen nga femrat.

Duke e ditur se roli i femrës në shoqëri është i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm, do të përpiqemi në eliminimin e diskriminimit në punë dhe profesion, sepse drejtësia sociale është themelore për të siguruar avancimin dhe fuqizimin e femrës në mënyrë të vazhdueshme.

Si në tere Kosovën, edhe në Komunën e Skenderajt po vërehet diskriminimi i femrës edhe në rastin e punësimit, e sidomos në sektorin privat. Arsyeja e këtij diskriminimi janë pushimi gjatë lindjes dhe lehonisë dhe paragjykimi se meshkujt janë më produktive në punë. Për këtë arsye femrat po

Implemented by:

diskriminohen edhe ne paga,sepse për pune te njëjtë me meshkujt marrin paga me te vogla. Këto dukuri negative janë bere shqetësim për shoqërinë ,sepse si pasoje e këtij diskriminimi social po shtyhen martesat dhe po zvogëlohet numri i lindjeve te fëmijëve. Prandaj gjate kësaj punëtorie theksuam se nenat dhe fëmijët kane nevojë për kujdes dhe ndihme te posaçme nga shoqëria dhe shteti.

Viti - z. Murat Abazi (Kryetar i SAF & SAM në këtë komunë)

Në vazhdimësinë e përpjekjeve të muajit Janar 2015 për plotësimin e kërkesave të kontratës kolektive një gjë të tillë e vazhduam edhe në muajin Shkurt ,në pritje dhe me biseda aktive me DKA në Viti,por një rezultat përfundimtar ende nuk është arritur në realizimin e



kontratës kolektive Vlen të theksohet se në tre grevat në komunën tonë janë përgjigjur të gjitha shkollat.

Në bisedë me DKA-në kemi kërkuar të na

mbështetin

financiarisht në mbajtjen e një takimi (darkë) solemne me rastin e 7 Marsit,ditën e mësuesit.

Andaj në vazhdimësinë e këtyre përpjekjeve më datën 16/02/2015 ,kemi pasur një takim me kryesinë e SAF & SAM në Viti, ku u diskutuan këto tema:

1. Përgatitja e një mbrëmje festive që do të mbahet me rastin e 7 Marsit.
2. U diskutua dhe për ofertën e MASHT -it drejtuar SBASHK-ut për realizimin e kërkesave që u dhanë

Te gjithë pjesëmarrësit u pajtuan për nevojën e nxitjes se avancimit te femrës ne shoqëri,duke e fuqizuar rolin e saj. Me ane te mësimi dhe edukimit do te ndihmohet me se miri respektimi i drejtave dhe roli te femrës ne shoqëri,sepse kështu ndikojmë edhe ne progresin tone kombëtar.

shumë vërejtje të arsyeshme si : të kërkohet nga Këshilli i përgjithshëm në Prishtinë që 0,5% të realizohet sa më parë dhe për shpenzimet e rrugës dhe tre paga të nënshkruhet në memorandum bashkëpunimi me DKA-në që këto kërkesat të realizohen .

Ndërsa për shujtën të shtyhet për një afat të sigurt që ti qoj në pezullim grevat e arsimtarëve deri kur qeveria të bëj rishikimin e buxhetit dhe të gjej mjete për realizimin e shujtës.

Gjithashtu u kërkua nga qeveria që të përkujtojnë se ne nuk kemi hequr dorë dhe nuk do heqim nga 25% i premtuar për ngritjen e pagave.

U njoftua kryesia se më 26/02/2015 ore 09:30 është thirrur séance gjyqësore për ankesat e punëtorëve të arsimit të cilët në zgjedhjet e fundit ishin kandidatë për asamble komunale dhe në kundërshtim më të gjitha ligjet në fuqi u ishin heq e drejta për pagesë gjatë fushatës deri në prezantim të rezultateve zgjedhore,që do të thotë për 3 muaj 16 punëtorë nuk kanë realizuar pagat e tyre,për këtë ne si kryesi jemi detyruar që kërkesat e tyre të i realizojmë në gjykatë komunale.

Shpresojmë që drejtësia të vendosë në favorin tonë dhe pagat të ju kthehen këtyre 16 punëtorëve.

SBASHK-u takoi Rektorin e Universitetit të Prizrenit, z.Ramë Vataj

Edhe Universiteti i Prizrenit në SBASHK



Në kuadër të vizitave komunave dhe institucioneve arsimore, një delegacion i SBASHK-ut, i përbërë nga kryetari z.Rrahman Jasharaj, menaxheri financiar z.Ymer Ymeri dhe asistente znj.Vlora Rexhepi, gjatë

këtij muaji kanë vizituar Universitetin publik "Ukshin Hoti" në Prizren.

Ata janë pritur fillimisht nga Rektori i këtij universiteti z.Ramë Vataj, i cili në bashkëbisedë me delegacionin e SBASHK-ut ka treguar për angazhimet që po bëhen këtu, në përpjekje për arritje sa më të mëdha.

Rektori z.Vataj ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe në një bashkëbisedë miqësore edhe me të punësuar tjerë në këtë universitet ishte pajtueshmëri e dy anshme që edhe këtu të formohet shoqata sindikale, gjë që rezultoi me anëtarësimin e këtij universiteti në SBASHK,ku pranuan nënshkrimet e tyre brenda pak ditësh.

Rektori tha se bashkëpunimi me SBASHK-un do të vazhdoj edhe në të ardhmen.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC

